



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
QENDRA KULTURORE

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**PROCESVERBAL-Tipi i kontratës - Punë**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE  
TEKNIKE DHEKRITEREVEPËRKUALIFIKIM**  
(Kyprocesverbal ështëpërefektpublikimi bashkëmedokumentet etenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Rikonstruksioni i galerisë”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**45210000-2;**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 12,988,333.00 (dymbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë

*paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40% e fondit limit, 0,4x12,988,333.00= 5,195,333,2 (pesë milion e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e tridhjetë e tre .2) lekë Pa TVSH**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

**2.2.2** Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2024.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).*

***Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

*“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.*

**Argumentimi:** Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistimin e taksave vendore”, indryshuar.

**2.2.3** Kopje të certifikuar të bilanceve të tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit si dhe të shoqëruara me AktEkspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

***Shënim:** Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:**

- Pune të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurrohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

- pune të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se

100% e fondit limit te kontrates qe prokurohet.

**\*Shenim:**

Me termin pune te ngjashme do te konsiderohen ato punime te ngjashme te realizuara ne godina me kompleksitet te njejte. Detyrimisht O.E. duhet qe, ne eksperiencen e tij, te kete realizuar zerat si F.V. te pajisjeve te ngjashme **Ashensore ose shkalle levizese**

Argumentimi i mesiperem eshte i bazuar ne aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi ku specifikohet se nje subjekt licensohet me pikat e licences profesionale sipas puneve te ngjashme te realizuara gjate viteve te fundit.

a) Për kontrata të realizuara me sektorin privat:

- Kontrate sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Aktin e kolaudimit(*në rastet kur ky dokumentacion lëshohet*)
- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat, për kyerjen me sukses të kontratës
- Faturat tatimore

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë përveç dokumentacionit të mësipërm, edhe:

- *Kontratën e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit*

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesëpërveç dokumentacionit të mësipërm, edhe:

- *Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.*

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Ne rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si deshmi për përvojen e mëparshme kërkon :
- i. Kontraten e Sipërmarrjes,

- ii. Situacionin perfundimtar te objektit
- iii. Aktin e Kolaudimit te objektit
- iv. Formular Vleresimi nga Investitori sipas shtojces nr. 9

b) Ne rast se punimet jane kryer ne sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si deshmi per pervojen e meparshme kerkon:

- i. Kontraten e Siper marrjes,
- ii. Situacionin perfundimtar te objektit
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor

Kontrata te ngjashme konsiderohen te vlefshme nese zerat kryesore te punimeve kane volume te konsiderueshme krahasimore te percaktuara ne kete prokurim.

*Pika a) plotesohet nga anetari i cili ka perqindjen me te madhe te pjesemarrjes ne bashkim. Anetaret e tjere te bashkimit do te paraqesin kontratat e ngjashme ne raport me perqindjen e pjesemarrjes se tyre ne bashkim. Kurse pika b) duhet te plotesohet nga te gjitha anetaret e bashkimit ne raport me perqindjen e pjesemarrjes se tyre ne bashkim.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % të vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatorit ekonomik ofertues i është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE – së, mbështetur në parashikimiet e nenit 88 të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përllorarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1, shkronja a) dhe b).

**2.3.2** Operoret ekonomike duhet te deshmojne se disponojne license profesionale per zbatim punimesh ne ndertim si dhe ne license te disponojne kategorite e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr.42, date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

Licensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

**Per punimet e pergjithshme te ndertimit:**

- N.P - 1 A Punime germimi ne toke;
- N.P - 3 B Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada;

Per punimet speciale te ndertimit:

- N.S-1 A Punime per prishjen e ndertimeve
- N.S-2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre;
- N.S-3 B Impiante ngritese dhe transportues (ashensore, shkalle levizese, transportues)
- N.S-4 A Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale
- N.S-12 A Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit;
- N.S-13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni;
- N.S-14 A Impiante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.
- N.S-18 A Punime topogjeodezike

*\* Per Operoret e huaj te behet njehesimi i licenses profesionale qe disponojne nga vendi i origjines prane Ministrise se Puneve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit ne plotesimin e licensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontrates.*

*\* Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike, Licensat profesionale duhet t’i paraqese operatori ekonomik qe ka marre persiper punimet per te cilat kerkohet Licensa Profesionale.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8 402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ku neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit,

projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Shënim: Pika e licencës për punime topogjeodezike është kërkuar për shkak se kemi të bëjmë me germim në tokë. Piketimi dhe kontrolli topografik duhet bërë në çdo fazë të zbatimit të punimeve..

#### ***NP-1 A Punime gjurmimi në tokë***

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjurmimi në tokë konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gjurmimi, sistemimi të dherave dhe ndryshime të volumit të tokës, si rezultat rikonstruksionit të shkolles 9 vjecare "Lef Sallata" . Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gjurmimit të dheut për shtesën anësore 3 kate të shkolles.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

#### ***N.P - 3 B Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada;***

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

#### ***N.S-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve***

Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

#### ***N.S-2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;***

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme

Për zbatimin e projekteve të impianteve hidrosanitare dhe atyre të mbrojtjes nga zjarri, të parashikuara në projektin e zbatimit është e domosdoshme që OE të zotërojë kapacitetet përkatëse të konfirmuar me pikën përkatëse të licensës së nevojshme për zbatimin e punimeve të tilla, sikurse parashikohet në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 më sipër cituar. Vendosja e këtij kriteri i referohet zgjidhjeve grafike, preventivit, specifikimeve teknike, relacioneve të projektit hidroteknik dhe atij të mbrojtjes nga zjarri, si dhe grafikut të

punimeve për zbatimin e projektit total. Në projektet respektive parashikohen impiantet hidrosanitare të furnizimit me ujë të tualeteve dhe të gjitha masat për mbrojtjen nga zjarri të objektit.

Këtu përfshihen të gjitha punimet për instalimin e këtyre rrjeteve, si dhe pajisjet dhe impiantet për vendosjen e tyre në funksion.

Kategoria A i referohet vlerës së këtyre punimeve në preventivin total dhe përcaktimeve të VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.

### ***N.S-3 B      Impiante ngritese dhe transportues (ashensore, shkalle levizese, transportues)***

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve transportuese, ashensorë, shkallë të lëvizshme, ngritëse dhe të transportit, komplet dhe të lidhur me çdo punim murature plotësuese ose ndihmëse që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

### ***N.S-4 A      Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale***

Vendosja e këtij kriteri u referohet punimeve të parashikuara në projektet teknikë, relacionet teknikë, specifikimet, preventivin dhe grafikun e punimeve për zbatimin e veprës. Këto punime parqiten të detajuara në projektin arkitekturor dhe specifikimet e punimeve ndërtimore. Punimet e parashikuara në këtë dokumentacion teknik përfshijnë punime murature, punime dyersh dhe dritaresh, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme, punimeve shtresash për izolimin termoakustik dhe punime të ndryshme izolimi. Vëllimi dhe vlerat e punimeve të tilla janë të konsiderueshme. Tipologjia e mureve, veshjeve, rifiniturave, dyerve dhe dritareve në objekt është e larmishme. Për zbatimin e punimeve të tilla, VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, përcakton se duhet të disponohet licenca NS-4.

Nga sa më sipër, duke marrë në analizë të gjithë dokumentacionin teknik, specifikën e punimeve dhe vlerat e të gjithë punimeve të tilla në preventivin total të kësaj ndërhyrjeje, u vendos si kriter teknik profesional licenca NS-4 B, e cila është e domosdoshme për vlerën, rëndësinë dhe kompleksitetin e punimeve të tilla.

### ***N.S-12 A      Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit;***

Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

### ***N.S-13 A      Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni;***

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara



me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

**N.S-14 A      *Impiante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.***

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

**N.S-18 A      *Punime topogjeodezike***

Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet te kete nje punesimin mesatar jo me pak se **40 (dyzet) punonjes** me kohe te plote pune per periudhen e fundit **6 (gjashte)** mujore nga data e hapjes se ofertave, ku perfshihen edhe Staf i menaxherial i Drejtuesve Teknik. Per vertetimin e ketij kushti te paraqiten:

1. Vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj per periudhen e mesiperme.
2. Listepagesa e Kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore te konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore per periudhen e mesiperme.

**Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga projektuesi, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri i punonjësve është vendosur bazuar në sasi të çdo zëri punimesh në preventiv dhe në natyrën e objektit të kësaj kontrate.

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesemarres, per realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet te disponoje stafin kryesor e mbeshtetes, punonjesit specialiste dhe çertifikimet perkatese, si me poshte:

a) Operoret ekonomik pjesemarres duhet te kene ne licence te shoqerise e te punesuar si drejtues Teknik ne stafin e tij per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome, CV, si dhe te figurojne detyrimisht ne listpagesat e shoqerise per periudhen e kerkuar ne piken 2.3.4, stafin inxhinierik si me poshte:

- 1 (nje) **Inxhinier Ndertimi Strukturor**
- 1 (nje) **Inxhinier Mekanik**
- 1 (nje) **Inxhinier Gjeoded (Topograf)**
- 1 (nje) **Inxhinier Hidroteknik**
- 1 (nje) **Inxhinier Elektrik**
- 1 (nje) **Inxhinier Gjeoteknik**
- 1 (nje) **Inxhinier Elektronik**
- 1 (nje) **Arkitekt**

b) Operatori Ekonomik pjesemarres duhet te jete i pajisur me Licence Restaurimi nga Ministria e Kultures ose duhet te disponoje pjese te stafit drejtues teknik Arkitekt/Inxhinier Restaurues me Licence A) Projektim dhe zbatim ne restaurimin e monumenteve te trashegimise se arkitektures  
A/2. Projektim dhe zbatim ne restaurimin te arkitektures antiko-mesjetare  
A/3. Projektim dhe zbatim ne restaurimin e ndertimeve civile,monumenteve te kategorise se pare dhe te dyte  
A/4.Porjektim dhe zbatim ne restaurimin e Qendrave Historike

Stafi mbeshtetes Operatori ekonomik duhet te kete te te disponoje dokumentacionin qe verteton profesionin si : Dëshmi profesionale te punonjesve ose ekuivalent te tij/saj , punonjesit e meposhtem me specialitetin si dhe te figurojn ne listpagesat e shoqerise sipas pikes mesiperme **2.3.5 :**

- 2 (dy) **Teknik i mesem Ndertimi** (Diplome e shkolles mesme) (Per punimet ndertimore)
- 1 (nje) **Teknik i mesem Topograf** (Diplome e shkolles mesme) (Per punimet ndertimore te mureve dhe te hekurit)
- 1 (nje) **Teknik i mesem Mekanik** (Diplome e shkolles mesme) (Per punimet mekanike dhe te ashensorit)
- 1 (nje) **Teknik i mesëm Termohidraulik** (Diplome e shkolles mesme) (Per instalimet hidrosanitare)
- 1 (nje) **Teknik i mesëm Elektroteknik** (Diplome e shkolles mesme) (Per punime elektroteknike te kablllove dhe te ashensorit)
- 5 (pese) **Murator/Suvatues (Per punimet e mureve)**
- 3(tre) **Hidraulik (Per instalimet hidraulike)**

- 4(kater) **Elektricist** (Per punimet elektrike)
- 6 (gjashte) **Bojaxhi (Per punimet e bojatisjes)**
- 2 (dy) **Saldator (Per saldimet e ndryshme)**
- 2 (dy) **Shtrues Parketi (Per punimet e parketit)**
- 4(kater) **Pllakashtrues (Shtrim pllakash dhe mermeri)**
- 3(tre) **Hidroizolues (Punime hidroizolimi)**
- 2 (dy) **Specialist Duralumini (Punimet e heqjeve te dritareve)**
- 2 (dy) **Specialist Gipsi (Punime gipsi)**
- 3 (tre) **Karpentier (Punime te kallepve)**
- 3(tre) **Hekurkthyes (Punime hekuri)**
- 2 (dy) **Punonjes Ashensori (Punime te ashensorit)**
- 2 (dy) **Instalues dhe riparues te kondicionereve dhe sistemeve ftohese-ngrohese (Punime te impianteve ngrohje ftohje**
- 1 (nje) **Mjek**

\* Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje dokumentacionin qe verteton profesionin si :

- Kontratat e punes individuale te vlefshme
- Per stafin e mesiperm, Deshmia e kualifikimit/ certifikate dhe/ose diploma e cila te jete e leshuar nga Ministria e Financave ose te njihet nga Ministria e Punes Ceshtjeve Sociale te paraqitet certifikata/diploma profesionale per secilin. Certifikatat / diplomat duhet te jene te leshuara nga institucione publike/private te licensuara sipas ligjit nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.*”, i ndryshuar. Kjo kerkese po ashtu eshte ne perputhje me vendimin nr. 441/2020, date 09.10.2020 te Komisionit te Prokurimit Publik. Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma te cilat nuk jane te licencuara sipas legjislacionit ne fuqi do te konsiderohen si dokumenta te rreme te cilat perbejne shkak per skualifikim dhe/ose perjashtimin e ketij kontraktori nga pjesemarrja ne prokurimet publike.
- Certifikate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT) e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise
- **Diplome** nga institucionet e arsimit te mesem profesional(publik/privat) te akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional ne RSH*”, kontrate pune te vlefshme dhe te figuroje ne listepagesa.
- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emri Mbiemër	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës	Nr. Amzës/ekuivalenti të diplomës/certifikatës profesionale	Institucioni/ subjekt i certifikues	Data e vlefshmerisë së certifikatës profesionale
----	--------------	------------	---	---	-------------------------------------	--

Kriteri konsiderohet i përbushur me paraqitjen e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

**Shenim:** Referuar pikes 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i **ndryshuar**, ku parashikohet: *“Bashkë me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-se, dhe në këto rregulla”,* si dhe përcaktimet e pikes 6, të këtij neni, ku parashikohet: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikes 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorezuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njesuara me origjinalin”.*

- d) Operatori Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) “Auditues energjie”, i cili duhet të jetë i pajisur me “Çertifikatë për Auditues Energjistik për ndertesa”, leshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë. Për këtë të paraqitet Kontrata Pune (e vlefshme) dhe certifikata nga institucioni përkatës

Audituesi i energjisë është i nevojshëm për hartimin e raportit mbi vlerësimin e efikasitetit të energjisë, sipas parashikimeve të nenit 16, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” parashikohet se: *“2. Auditimi energjetik shoqërohet me një raport që përfshin: a) një vlerësim të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik; b) propozimin e masave të kursimit të energjisë që duhen marrë, përfshirë justifikimin ekonomik; c) të dhëna për sasitë totale të kursimeve të mundshme; ç) opinionin përfundimtar të audituesit energjetik për potencialin për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe masat teknike përkatëse. 3. Audituesi i dërgon një kopje të raportit të auditimit energjetik Agjencisë për Eficencën e Energjisë për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm”.*

*Shenim: Kjo kërkesë përbushet nepermjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar ne vend te pare, prane autoritetit kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, ose nese do te jete nevoja per tu kerkuar sqarime nga AK.*

- e) Operatoret ekonomik pjesemarres duhet te jene te punesuar si staf mbeshtetes per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, te pajisur me certifikate/deshmi trajnimi te leshuar nga subjekte te akredituar sipas ligjit, si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqerise per periudhen e kerkuar ne piken 2.3.4, punonjes me specialitetin si me poshte:
- Minimumi **1** (nje) **persona** qe permbush kriteret per te qene **“Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune”** leshuar nga organe te akredituar te njohur nga Republika e Shqiperise.
  - Minimumi **1** (nje) **person** qe permbush kriteret per te qene **“Ekspert Zjarrfikes i pajisur me Licence I.2.A** ne perputhje me piken 4, te nenit 49, te Ligjit Nr.152/2015 “Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin”. Per kete duhet te paraqitet Certifikate/deshmi per ekspert zjarrfikes te leshuar nga Ministria e Puneve te Brendeshme, diploma dhe kontrata noteriale e punes.”
  - Minimumi **9** (nente) punonjes te specializuar dhe certifikuar **per perdorim dhe punime ne skela**, te cilet duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise per periudhen e kerkuar ne piken 2.3.6, ku per permbushjen e kesaj pike operatori ekonomik ofertues duhet te deklaroje punonjesit ne seksionin perkates te Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST, si dhe *ne rast se kualifikohet, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit*, per secilin punonjes, duhet te paraqese dokumentacionin: kontrata e punes e vlefshme, dhe certifikatat perkatese.
- f) Kandidati ofertues duhet te percaktoje me ane te nje deklarate (nga Administratori i shoqerise dhe vete Drejtuesi Teknik) Drejtuesin Teknik te punimeve ne objekt i cili duhet te jete i perfshire ne licencen e shoqerise dhe te deklaraje se ai nuk eshte i angazhuar ne kontratat te tjera gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt, shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem:
- Libreze pune (perkatese)
  - CV EU format perkatese
  - Kontrate pune e vlefshme (perkatese)
  - Diplome

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që

operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

### **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), leshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si me poshte :

- Eskavatorist 2 (dy)
- Automakinist 2 (dy)

*(Ne rastet kur mjetet/makinerite disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).*

Per këte operatoret ekonomike duhet të paraqesin :

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vertetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “*Per kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhenien e Dëshmise se Aftësive Profesionale për përdoruesit e makinërive të renda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre*”, miratuar me urdherin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastruktura dhe Energjitikës.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatoret ekonomike të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, ose nëse do të jetë nevojë për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**Argumentim:** Në kriterin mesipercituar është kërkuar që OE të kenë të punësuar teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh.

Vendosja e këtij kriteri lidhet drejtpërdrejtë me mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës.

Për manovrimin e makinërive mbi bazë automjeti, ku përfshihen autovinça, autobetoniere, autopompa betoni, autobot është kërkuar kategoria e punonjësve të kualifikuar automakinist.

Kjo kërkesë mbështetet në kategorizimet e përcaktuara në Urdhërin e ministrit të Infrastruktura dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet

për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, neni 8, pika 1c që përcakton se, *automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti:- autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak manovratorëve u jepet dëshmi për AUTOMAKINIST.*

Për manovrimin e makinerive të gërmimit dhe ngarkimit të dherave ku përfshihen minifadromat dhe fadromat e llojeve të ndryshme dhe eskavatorët e ndryshëm janë kërkuar eskavatoristë.

Kjo kërkesë mbështetet në kategorizimet e përcaktuara në Urdhërin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, neni 8, pika 1a, sipas së cilës, *eskavator gërmimi e ngarkimi dherash:- të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për ESKAVATORIST.*

**2.3.7** Operatori ekonomik pjesëmarres duhet të ketë licence lidhur me ndikimin në mjedis të leshuar nga QKL kodë III.2.B **“Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendim Nr. 538 date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa”. si dhe ne permbushje te detyrimeve ligjore qe percakton Ligji 10431 date 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (te ndryshuar).

Ky kriter synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe demtimi prej mbetjeve të ngurta, nepermjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, perpunimin, magazinimin, asgjësimin, të cilat çojnë në pakesimin e mbetjeve dhe zvogelimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të demshme. Duke qenë se në preventivin e punimeve janë pasqyruar punime prishje, gërmimi është gjykuar që subjekti duhet të ketë lejen e posaçme për veprimtari të tilla si Stacionim transferimi për mbetjet nga prishjet dhe ndërtimet, për mbetjet e ngurta urbane dhe magazinim i perkoshem i tyre.

### **2.3.8 (Makineri, Pajisje)**

**a) Operatori ekonomik pjesëmarres, për realizimin e kontratës, duhet të**

**disponoje**, automjetet dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vertetuara këto me dokumentacionin përkatës;

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Ekskavator me goma	2 cope	Pronësi ose me qira
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 5-10 ton	3 cope	Pronësi ose me qira
Kamioncine me kapacitet mbajtes 1-3 ton	3 cope	Pronësi ose me qira
Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton	2 cope	Pronësi ose me qira
Autovinç mbi 20t per ashensorin	1 cope	Pronësi ose me qira
Depozite uji 5000 l	2 cope	Pronësi ose me qira
Vibrator	4 cope	Pronësi ose me qira
Autobetoniere	2 cope	Pronësi ose me qira
Autopompe betoni	1 cope	Pronësi ose me qira
Pompe suvatimi	1 cope	Pronësi ose me qira
Helikopter nivelues	1 cope	Pronësi ose me qira
Skeleri	min 2000 m <sup>2</sup>	Pronësi ose me qira
Betoniere 0.25-0.5 m <sup>3</sup>	2 cope	Pronësi ose me qira
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qira
Mini fadrome	1 cope	Pronësi ose me qira
Instrument per punime gjeodezike	1 cope	Pronësi ose me qira
Fabrike Betoni jo me larg se 30 km nga objekti	1 cope	Pronësi, me qira ose aktmarveshje furnizimi

- b) Gjithashtu në zbatim të VKM-se Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtëse në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:
- Kokore – jo me pak se 40 cope
  - Jeleke – jo me pak se 40 cope



- Prozhektore ndriçimi naten – *jo me pak se 40 cope*
- Komplet i ndihmes se shpejte – *jo me pak se 5 cope*
- Fikese zjarri te levizshme me kapacitet 5-7 litra – *jo me pak se 10 cope*
- Tabela paralajmeruese per sigurine ne objekt – *jo me pak se 10 cope*
- Rripa sigurie – *jo me pak se 40 cope*

□ Per vertetimin e disponimit te makinerive dhe pajisjeve te kerkuara me lart, te paraqiten:

- 1- Per mjetet qe shenohen ne rregjistra publike duhet te paraqitet dokument qe verteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikaten e Kontrollit Teknik (*te vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*te vlefshme*).
- 2- Per mjetet e siguruar me qira, te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per kete objekt, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt e ketij prokurimi, shoqeruar me Akt - Pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar plus dokumentat qe verteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikaten e Kontrollit Teknik (*te vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*te vlefshme*).
- 3- Per paisjet ne pronesi te shoqerohen me Akt - Pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi*).
- 4- Per paisjet me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per kete objekt, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt e ketij prokurimi, shoqeruar me Akt - Pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi*).
- 5- Operatori ekonomik nuk duhet t'i kete kapacitetet teknike te angazhuara ne kontratat te tjera dhe nuk duhet te jene te deklarurara ne procedura te shpallura fituese (**deklarate me shkrim nga Administratori i Shoqerise**)

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

- Mjetet e tjera që kërkohen i referohen sigurisë dhe shëndetit në kantier. Numri i kërkuar për secilin nga këto mjete i referohet numrit të personelit të kërkuar.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas

standartave, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentat konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit

### **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën ISO, si me poshte:

- **ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë)**
- **ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor)**
- **ISO 50001:2011 (Sistem i Menaxhimit të Energjisë)**
- **ISO 45001:2018 (Sistem i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në punë)**

Çertifikata e mesiperme duhet të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikata e mesiperme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Ne rast të bashkimit të operatoreve ekonomike ISO duhet plotësuar nga operatorët ekonomikë, sipas natyrës së punëve që marrin persiper.*

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

**ISO 9001:2015** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i

pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**ISO 14001:2015** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

**ISO 45001-2018** është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi

**ISO 50001-2011** – Kjo ISO specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e një sistemi të menaxhimit të energjisë, qëllimi i të cilit është të mundësojë një organizatë që të ndjekë një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, duke përfshirë efikasitetin e energjisë, përdorimin dhe konsumimin e energjisë.

#### Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë

tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

**Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës dhe shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve, bazuar në VKM-në të VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.**